

ASG sh.p.k.
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur
më 31 dhjetor 2015

8

PËRMBAJTJA:

	FAQE
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	1
PASQYRA E PERFORMANCËS	2
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	3
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	4
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	5 - 19

8

Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2015

	Shënime	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
AKTIVE			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	1,180,822	565,987
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	57,248,456	47,135,200
Të tjera llogari të arkëtueshme	6	77,048,518	54,854,962
Paradhënie dhe shpenzime të shtyra	7	7,926,195	6,861,508
Total aktive afatshkurtra		143,403,991	109,417,657
Aktivitet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	8	751,370,157	599,920,359
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	9	12,279,449	10,118,505
Total aktive afatgjata		763,649,606	610,038,864
Total aktive		907,053,597	719,456,521
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	10	92,775,286	176,085,077
Llogari të pagueshme tregtare	11	93,173,853	83,764,446
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	12	36,568,518	
Parapagime të arkëtuara	13	152,845	
Detyrime tatimore	14	1,224,891	2,894,314
Grante dhe të ardhurat e shtyra	15	18,988,433	5,311,134
Të tjera detyrime	16	157,962	200,837
Total detyrime afatshkurtra		243,041,788	268,255,808
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata	17	437,224,368	254,031,530
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	18	190,632,909	177,004,624
Total detyrime afatgjata		627,857,277	431,036,154
Totali i detyrimeve		870,899,065	699,291,962
Kapitali			
Kapitali i nënshkruar		8,400,000	4,900,000
Rezerva ligjore		10,000	10,000
Rezerva të tjera		15,254,559	15,234,441
Fitime të mbartura		-	-
Fitimi i ushtrimit		12,489,973	20,118
Total kapitali	19	36,154,532	20,164,559
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		907,053,597	719,456,521

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 19, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014	
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	20	460,912,941	225,289,829
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	21	11,076,028	6,843,367
Lëndë të para, materiale dhe shërbime		(301,572,648)	(105,322,627)
1) Lënda e pare dhe materiale të konsumueshme	22	(262,070,519)	(59,539,263)
2) Të tjera shpenzime	23	(39,502,129)	(45,783,364)
Shpenzime te personelit	24	(25,283,220)	(18,264,203)
1) Paga dhe shpërblime		(19,412,700)	(15,745,232)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore		(5,870,520)	(2,518,971)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	25	(99,021,036)	(70,597,932)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	26	(2,599,346)	(2,778,930)
Zhvlerësim i aktiveve financiare dhe investimeve të mbajtura si aktive afatshkurtra		-	
Shpenzime financiare		(24,552,329)	(30,671,722)
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme	27	(36,888,044)	(34,558,050)
2) Shpenzime të tjera financiare	28	12,335,715	3,886,328
Fitimi/humbja para tatimit		18,960,390	4,497,782
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		(6,470,417)	(4,477,664)
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	29	(6,470,417)	(4,477,664)
2) Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë			
Fitimi/humbja e vitit		12,489,973	20,118
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin:			
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin:			
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin:		12,489,973	20,118

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 19, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

ASG sh.p.k.

(Vlerat janë në Lekë)

**Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva të tjera	Rezerva ligjore	Fitime (Humbje) të mbartura	Fitim (Humbje) e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 1 janar 2014	4,900,000	14,802,682	10,000	-	431,759	20,144,441
Rritje kapitali						
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin :				20,118	20,118	20,118
Transferim në rezervave të tjera		431,759		(431,759)		
Dividendë të paguar						
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse:						
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2014	4,900,000	15,234,441	10,000	-	20,118	20,164,559
Rritje kapitali						
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin :	3,500,000					3,500,000
Transferim në rezervave të tjera		20,118			12,489,973	12,489,973
Dividendë të paguar					(20,118)	
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse:						
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2015	8,400,000	15,254,559	10,000	-	12,489,973	36,154,532

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 19, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 janë aprovuar nga administratori i ASG sh.p.k. më ___ mars 2016 dhe janë firmosur si më poshtë.

Gazmend Haxhia

Z. Gazmend Haxhia
 Administrator

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	12,489,973	20,118
<i>Rregullimet për shpenzimet jomonetare:</i>		
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar	403,126	106,899
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	99,021,036	70,597,932
Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:		
Fitim/(humbje) nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	34,744,981	
Vlera kontabël neto e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit	8,424,393	
Diferenca këmbimi jo nga aktivitete operative	(11,985,033)	(243,519)
<i>Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:</i>		
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(32,306,812)	18,323,656
Rënie/(rritje) në inventarë		
Rënie/(rritje) në shpenzime të shtyra	(1,064,687)	(1,576,461)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	57,692,645	17,506,784
Rritje/(rënie) në parapagimet e arkëtuara		(8,927,936)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	167,419,622	95,807,473
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(304,094,026)	(151,718,285)
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	10,453,818	34,259,677
Ndryshime në huadhënie afatgjatë	(2,160,944)	7,813,732
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(295,801,152)	(109,644,876)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Arkëtime nga emetimi i kapitalit	3,500,000	
Rritje/(rënie) në hua të tjera afatgjata	13,628,285	65,730,709
Rritje/(rënie) në detyrime të qirasë financiare	112,218,762	(54,246,643)
Dividendë të paguar		
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	129,347,047	11,484,066
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	965,517	(2,353,337)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	565,987	2,909,480
<i>Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare</i>	(350,682)	9,844
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	1,180,822	565,987

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

ASG shp.k (Kompania) është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më 23 gusht 2000 në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 « Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare ».

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është dhënia e automjeteve me qera, transport ndërkombëtar udhëtarësh, shërbime parkingu e lavazhi.

Kapitali themeltar i shoqërisë është 8,400,000 Lekë (2014: 4,900,000 Lekë) i cili zotërohet nga ortaku z.Gazmend Haxhia.

Shoqëria është e regjistruar pranë degës së Tatim Taksave në Tiranë më NIPT K02023001Ë. Selia qendrore e saj është në Rr Themistokli Gërmenji, Tiranë.

Administratori i shoqërisë është Z. Gazmend Haxhia.

Në 31 dhjetor 2015 shoqëria kishte 124 punonjës.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Në bazë të urdhrit nr. 64 datë 22.7.2014 “Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre”, Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)**2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme**

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 është riparaqitur për të korresponduar me paraqitjen e re të pasqyrave financiare siç kërkohet nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Euro/Lek	137.28	140.14
USD/ Lek	125.79	115.23

(Vlerat janë në Lekë)

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitet financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitet financiar ose kur shoqëria transferon aktivitet financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitet. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivitet. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitorit të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë.

Hua të marra dhe të dhëna


Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.



7

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja


Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.



3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Amortizimi vjetor pasqyrohet në pasqyrën e të ardhurave e shpenzimeve.

Shoqëria llogarit amortizimin e Aktiveve Afatgjata Materiale bazuar në jetën e dobishme të tyre sipas gjykimit të manaxhimit.

Në përputhje me SKK nr. 5 paragrafi 41 sipas të cilit "Përshtatshmëria e normave të amortizimit, metodave të amortizimit dhe përlogaritjes së vlerave të recuperueshme duhet të rishihet rregullisht. Nëse konstatohet se jeta e dobishme aktuale e një aktiviteti afatgjatë material ndryshon dukshëm nga përlogaritja fillestare, periudha e amortizimit duhet të ndryshohet. Gjithashtu nëse është e nevojshme, duhet të ndryshohen metodat e amortizimit dhe zvogëlimi i vlerës së mbetur të përlogaritjes të një aktiviteti afatgjatë material. Efekti i ndryshimit të periudhës së amortizimit ose vlerës së rikuperimit do të kontabilizohet si ndryshim në vlerësimet kontabël, në përputhje me udhëzimet e SKK 1 (dmth në periudhën aktuale e ato të ardhshme, dhe jo në menyre retrospektive).

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundur që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shoqëria për kryerjen e aktivitetit të saj jep qira operative, si dhe merr nga të tretët qira operative dhe financiare.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2015 është 15% (2014: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

(Vlerat janë në Lekë)

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.13. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Mjete monetare në Lekë	1,018,004	226,780
Banka	574,730	138,751
Arka	443,274	88,029
Mjete monetare në valutë	162,818	339,207
Banka	162,805	276,329
Arka	13	62,878
	<u>1,180,822</u>	<u>565,987</u>

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Klientë	57,248,456	47,135,200
	<u>57,248,456</u>	<u>47,135,200</u>

6. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Debitorë të tjerë	1,512,198	1,540,199
TVSH për t'u rimbursuar	75,536,320	53,314,763
	<u>77,048,518</u>	<u>54,854,962</u>

7. Paradhëniet dhe shpenzime të shtyra

Paradhëniet dhe shpenzimet e shtyra detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Shpenzime të shtyra	7,926,195	6,861,508
Paradhënie		-
	<u>7,926,195</u>	<u>6,861,508</u>

ASG sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(Vlerat janë në Lekë)

8. Aktive Afatgjata Materiale

	Makineri e pajisje instalime teknike	Mjete transporti	Pajisje komjuterike	Pajisje zyre	Totali
Kosto					
Gjendja më 1 janar 2014	8,544,794	770,524,481	2,118,498	10,307,764	791,495,537
Shtesa		150,648,527	1,069,758		151,718,285
Pakësime		(81,198,523)			(81,198,523)
Gjendja më 31 dhjetor 2014	8,544,794	839,974,485	3,188,256	10,307,764	862,015,299
Shtesa		304,063,309	30,718		304,094,027
Pakësime		(118,623,526)			(118,623,526)
Gjendja më 31 dhjetor 2015	8,544,794	1,025,414,268	3,218,974	10,307,764	1,047,485,800
Amortizimi i akumuluar					
Gjendja më 1 janar 2014	3,429,726	228,226,339	1,611,105	5,168,683	238,435,853
Amortizimi i vitit	719,680	68,428,971	380,737	1,068,544	70,597,932
Pakësime		(46,938,845)			(46,938,845)
Gjendja më 31 dhjetor 2014	4,149,406	249,716,465	1,991,842	6,237,227	262,094,940
Amortizimi i vitit	879,078	97,028,748	299,103	814,107	99,021,036
Pakësime		(65,000,334)			(65,000,334)
Gjendja më 31 dhjetor 2015	5,028,484	281,744,879	2,290,945	7,051,334	296,115,642
<i>Vlera neto kontabël</i>					
Gjendja më 31 dhjetor 2014	4,395,388	590,258,020	1,196,414	4,070,537	599,920,359
Gjendja më 31 dhjetor 2015	3,516,310	743,669,389	928,029	3,256,430	751,370,157

9. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Huadhënie afatgjata	12,279,449	10,118,505
	<u>12,279,449</u>	<u>10,118,505</u>

10. Hua afatshkurtra

Huatë afatshkurtra më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Hua nga BKT	61,687,566	30,577,971
Qira financiare nga Raiffeisen Leasing	13,744,068	101,022,476
Hua nga Emporiki bank	16,496,878	44,484,630
Overdraft	846,774	
	<u>92,775,286</u>	<u>176,085,077</u>

11. Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Furnitorë	93,173,853	83,764,446
	<u>93,173,853</u>	<u>83,764,446</u>

12. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	36,568,518	-
	<u>36,568,518</u>	<u>-</u>

13. Parapagime të arkëtuara

Parapagimet e arkëtuara më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Parapagimet e arkëtuara	152,845	-
	<u>152,845</u>	<u>-</u>

14. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Detyrime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	793,800	321,980
Detyrime për tatimin mbi të ardhurat personale	27,965	21,686
Tatim fitimi	403,126	106,899
TVSH për t'u paguar	-	2,443,749
	<u>1,224,891</u>	<u>2,894,314</u>

15. Grante dhe të ardhura të shtyra

Grantet dhe të ardhurat e shtyra më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 paraqiten si në vijim :

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Të ardhura të shtyra	18,988,433	5,311,134
	<u>18,988,433</u>	<u>5,311,134</u>

16. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 për kompaninë vijnë si më poshtë :

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Detyrime ndaj punonjësve	157,962	164,056
Të tjera	-	36,781
	<u>157,962</u>	<u>200,837</u>

17. Hua afatgjata

Huatë afatgjata më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 janë si më poshtë :

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Hua afatgjata	437,224,368	254,031,530
	<u>437,224,368</u>	<u>254,031,530</u>

18. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 janë si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	190,632,909	177,004,624
	<u>190,632,909</u>	<u>177,004,624</u>

19. Kapitali

Kapitali i nënshkruar i shoqërise është 8,400,000 Lekë dhe zotërohet 100% nga ortakut Gazmend Haxhia:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Numri i kuotave	1	1
Vlera nominale (në LEK)	8,400,000	4,900,000
Kapitali i nënshkruar	<u><u>8,400,000</u></u>	<u><u>4,900,000</u></u>

Rezerva ligjore nuk ka ndryshim nga vitit paraardhës, dhe paraqitet në shumën 10,000 Lekë.

Rezerva të tjera paraqiten në vlerën 15,254,559 Lekë (2014: 15,234,441 Lekë).

20. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Të ardhura nga shërbimet	60,615,415	34,078,441
Të ardhura nga qiraja	241,535,231	177,356,988
Të ardhura nga shitja e makinave	57,783,300	-
Të ardhura nga transporti	91,727,470	2,418,463
Të ardhura nga parkimi	9,251,525	11,435,937
	<u><u>460,912,941</u></u>	<u><u>225,289,829</u></u>

21. Të ardhura të tjera nga shfrytëzimi

Të ardhurat e tjera nga shfrytëzimi për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 janë si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Të ardhura nga komisionet	1,651,070	1,210,385
Të ardhura nga siguracionet	9,996,800	5,294,540
Të ardhura të tjera	420,677	245,049
Shpenzimet nga këmbimet valutore për marrëdhëniet tregtare	(635,866)	(19,776)
Të ardhurat nga këmbimet valutore për marrëdhëniet tregtare	(356,653)	113,169
	<u><u>11,076,028</u></u>	<u><u>6,843,367</u></u>

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së.

	<u>31 dhjetor 2015</u>
Qarkullim i tatueshem	476,661,987
Shtohen të ardhura të marra nga viti 2014	5,311,134
Zbriten të ardhurat e shtyra per periudhat e ardhëshme	(18,988,433)
Shtohen të ardhurat nga siguracionet pa faturë	9,996,800
Shtohen të ardhurat financiare nga aktiviteti operativ	(92,519)
Shuma e qarkullimit e korrektuar	471,988,969
Sipas Kontabilitetit	471,988,969
Diferenca	<u><u>-</u></u>

22. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Shpenzimet për lëndë të para dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Kosto e makinave të shitura	89,844,858	-
Karburant	54,112,619	16,742,417
Siguracione	20,307,632	16,392,792
Mirëmbajte automjesh	42,105,119	21,124,625
Dieta shoferët	35,357,386	-
Qira automjesh	8,836,950	3,134,592
Taksat e regjistrimit	992,580	750,361
Shpenzime akomodimi	10,228,478	-
Të tjera shpenzime	-	68,600
Aksesorë	284,897	1,325,876
	<u>262,070,519</u>	<u>59,539,263</u>

23. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Blerje ujë , energji	71,904	-
Qira	12,359,540	13,459,311
Siguracion	212,205	-
Taksa të ndryshme	143,818	99,721
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	4,460,645	5,892,131
Shpenzime mirëmbajtjeje	70,723	743,641
Shpenzime bankare	2,099,453	1,436,274
Shpenzime transporti	9,106,181	-
Shpenzime noteriale	897,237	354,707
Vlera kontabel neto e aktiveve te nxjera jashtë përdorimit	8,424,393	22,948,782
Shpenzime të tjera	1,656,030	848,797
	<u>39,502,129</u>	<u>45,783,364</u>

24. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Shpenzime page	19,412,700	15,745,232
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	5,870,520	2,518,971
	<u>25,283,220</u>	<u>18,264,203</u>

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2015 është 124.

25. Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi

Shpenzimet e zhvlerësimit dhe amortizimit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Shpenzime amortizimi	99,021,036	70,597,932
	<u>99,021,036</u>	<u>70,597,932</u>

26. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjokat dhe penalitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Gjoka dhe dëmshpërblime	2,599,346	2,778,930
	<u>2,599,346</u>	<u>2,778,930</u>

27. Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme

Shpenzimet e interesit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Shpenzime interesi	(36,888,698)	(34,558,050)
Te ardhura nga interesi	654	-
	<u>(36,888,044)</u>	<u>(34,558,050)</u>

28. Shpenzime të tjera financiare

Shpenzimet e tjera financiare përfshijnë efektet e lëvizjeve të kurseve të këmbimit, këto shpenzime paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Të ardhura/(shpenzime) nga kursi i këmbimit nga aktiviteti financiar	12,335,715	233,675
Te ardhura te tjera financiare		3,652,653
	<u>12,335,715</u>	<u>3,886,328</u>

29. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Fitimi para tatimit	18,960,390	4,497,782
Shpenzime të panjohura (si më poshtë)	24,175,721	25,353,310
Penalitet, gjoja e dëmshpërblime	2,599,340	2,778,920
Shpenzime interesash të panjohura	21,576,381	22,574,390
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	43,136,111	29,851,092
Tatim fitimi @15%	6,470,417	4,477,664
	<u>12,489,973</u>	<u>20,118</u>

30. Transaksionet me palët e lidhura

Balancat dhe transaksionet me palët e lidhura më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2015	Më 31 dhjetor 2014
Bilanci kontabël		
<i>Të arkëtueshme nga palët e lidhura</i>		
Noshi shpk	-	-
Huadhënie afatgjatë		
Noshi shpk	11,651,918	10,118,505
	11,651,918	10,118,505
<i>Të pagueshme ndaj palëve e lidhura</i>		
Albania Experience	9,600,000	-
Noshi shpk	26,968,518	-
	36,568,518	-
<i>Të tjera të pagueshme ndaj palëve e lidhura</i>		
Albania Experience	190,632,909	177,632,155
	190,632,909	177,632,155
	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve		
<i>Shitje palëve të lidhura</i>		
Albania Experience	91,555,925	26,295,806
	91,555,925	26,295,806
Blerje nga palët e lidhura		
Albania Experience	9,600,000	-
Noshi shpk	23,943,145	8,826,874
	33,543,145	8,826,874

31. Angazhime dhe pasiguri

Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 dhjetor 2015 shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në menyrë të besueshme.

32. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

